



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:052469  
Datë: 12.10.2021  
Numri i dokumentit: 02269990

**C.nr.337/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** Gjyqtarja Afijete Sada - Gllogjani, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve M. A., M. Q., M. S., Q. D. dhe N. H., që të gjithë nga Gjakova, të përfaqësuar nga i autorizuari Labinot Buzuku, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të cilën e përfaqëson i autorizuari Musë Gjergjaj, për kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 6,569.01€, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor të mbajtur me 05 tetor 2021, në prezencën e të autorizuarit të ndërgjyqësve, përpiluar me datë 12 tetor 2021, murr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses M. A. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të kompensimit të tre (3) pagave për shpërblim jubilar, të ia paguajë shumën prej 1,305.21 euro (një mijë e treqind e pesë euro e njëzetë e një cent) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 05 tetor 2021 deri në pagimin definitiv, e këtë në afatin prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**II. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses M. Q. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të kompensimit të tre (3) pagave për shpërblim jubilar, të ia paguajë shumën prej 1,276.65 euro (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 05 tetor 2021, deri në pagimin definitiv, e këtë në afatin prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**III. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses M. S. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të kompensimit të dy (dy) pagave për shpërblim jubilar, të ia paguajë shumën prej 1,397.52 euro (një mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 05 tetor 2021, deri në pagimin definitiv, e këtë në afatin prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**IV. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Q. D. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të kompensimit të tre (3) pagave për shpërblim jubilar, të ia paguajë shumën prej 1,284.42 euro (një

mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër euro e katër dhjet e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 05 tetor 2021, deri në pagimin definitiv, e këtë në afatin prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**V. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit N. H. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditësit në emër të kompensimit të tre (3) pagave për shpërblim jubilar, të ia paguajë shumën prej 1,305.21 euro (një mijë e treqind e pesë euro e njëzetë e një cent) me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 05 tetor 2021, deri në pagimin definitiv, e këtë në afatin prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

**VI. DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditësve të iu kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 738,60€, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Paditësit në padi, në precizimin e kërkesë padisë dhe gjatë shqyrtimit në këtë çështje juridike, nëpërmes të autorizuarit të tyre kanë theksuar se janë të punësuar tek e paditura me kohë të pacaktuar. Me 11 qershor 2018, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kanë nënshkruar “Kontratë Kolektive Sektoriale” në kohëzgjatje prej 3 viteve bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës, e cila në bazë të nenit 4 gjen zbatim për të gjithë personat e punësuar nëpër institucionet shëndetësore. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata e lartpërmendur nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësit kanë qenë të detyruar që të parashtrojë padi dhe të kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre subjektive.

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimit ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, ku në vend të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Gjakovë, duhet të jetë Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e që në rastin konkret i autorizuari i të paditurës nuk e ka kundërshtuar propozimin e sipër cekur (për çka gjykatës i ka prezantuar edhe autorizimin nga i cili rezulton se i njëjti ka tagër për përfaqësim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Komuna e Gjakovës. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka deklaruar se me provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e saj, me çka ndërmjet palëve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune, përvoja e punës dhe paga mujore, andaj i propozoj gjykatës që në tërësi të aprovon kërkesë padisë e precizuar duke e detyruar të paditurën që paditësve të ju bëjë kompensimin për shpërblim jubilar të përcaktuar si në dispozitiv të kërkesë padisë, së bashku me kamatë ligjore 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, ndërsa shpenzimet e procedurës kontestimore si në parashtrësën e sotme.

E paditura në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka mbet pranë përgjigjes në padi dhe ka shtuar se sa i përket precizimit të shumës së kërkesë padisë ajo është mbështetur në bazë të provave të ofruara nga e paditura, ndërsa sa i përket themelësisë së kërkesëpadisë, mbetem pranë përgjigjes në padi me anë të cilës ka kundërshtuar pasi e paditura konsideron që kërkesëpadia është e parashkruar duke u mbështetur në nenin 17.3 të Kontratës kolektive sektoriale pasi paditësit kërkesën është dashur t’a bëjë fillimisht për 10 vite e jo tani siç është cekur në kërkesëpadi tani për 30 vjet. Të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv pasi që e njëjta nuk ka qenë palë nënshkruese në Kontratën Kolektive Sektoriale dhe si e tillë asnjë institucion

nuk mund të obligoi shpenzime pa miratimin e komunës, përkatësisht të paditurës, kjo mbështet në legjislacionin në fuqi përkatësisht në Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe në Ligjin për shëndetësi me anë të cilit sistemi parësorë shëndetësorë menaxhohet dhe financohet nga komuna dhe jo nga Ministria. Nuk është kontestuese se të gjithë paditësit janë në marrëdhënie pune të pandërprerë dhe kanë qenë tek e paditura. Andaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të refuzohet si e pathemeltë.

Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi.

Për të vendosur në këtë çështje juridike gjykata bëri nxjerrjen e provave: Kontrata e punës nr. 266, datë 22 mars 2012, vërtetimi nr.24/25, datë 27 janar 2020, vërtetimi nr.383/10, datë 27 shtator 2021, deklarata e llogarisë Pro Credit Bank, datë 28 janar 2020 dhe letërnjoftimit me nr. pers.1003345994 - MPB Kosovës për paditësen M. A.. Kontrata e punës nr. 220, datë 01 prill 2012, vërtetimi nr. 24/91, datë 28 janar 2020, Qarkullimi për llogarinë NLB Bank, 29 janar 2020, vërtetimi nr. 383/11, datë 27 shtator 2021 dhe letërnjoftimit me nr. pers.1009235864 MPB Kosovës, për paditësen M. Q.. Kontrata e punës nr. 146, datë 21 mars 2012, Vërtetimi nr. 24/97, datë 29 janar 2020, vërtetimi nr.383/12, datë 27 shtator 2021, Qarkullimi për llogarinë NLB Bank, datë 29 janar 2020, letërnjoftimi me nr.pers.1013495153 për paditësen M. S.. Kontrata e punës datë 01 prill 2012, vërtetimi nr. 24/46, datë 28 janar 2020, vërtetimit nr. 383/13, datë 27 shtator 2021, monitorimi i transaksioneve të llogarisë TEB bank, datë 28 janar 2020, letërnjoftimit me nr. pers.1009334820 për paditësen Q. D.. Kontrata e punës nr. 294, datë 22 mars 2012, vërtetimi nr. 24/126, datë 29 janar 2020, vërtetimi nr. 383/14, datë 27 shtator 2021, monitorimi i transaksioneve të llogarisë, TEB Bank, datë 29 janar 2020, letërnjoftimi me nr. pers.1005606833 për paditësin N. H., ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësve është e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë, pasi që pala e paditur është pajtuar me ndryshimin e bërë dhe duke u bazuar në nenin 258 të LPK-së.

Nga provat e zbatuara rezultojë gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontrata e punës nr. 266, datë 1 prill 2012, vërtetohet se paditësja M. A. ka lidhur kontratë me Qendrën e Mjekësisë Familjare - 3, nga data 01.04.2012 – në periudhë të pa caktuar, ndërsa nga vërtetimi nr. 24/25 datë 27 janar 2020, provohet se këtu paditësja është në marrëdhënie pune: infermiere në QMF – 3, me kontratë pune në kohë të pacaktuar nga data 22 qershor 1987. Po ashtu nga vërtetimi nr. 383/10 datë 27 shtator 2021 vërtetohet rrethana se paditësja e lartpërmendur, në cilësinë e infermieres, ka 37 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në lartësi 435,07€. Sipas deklaratës së llogarisë e lëshuar Pro Credit Bank, datë 28 janar 2020 është provuar se e njëjta realizon pagë prej 431.91€.

Nga Kontrata e punës nr. 220 datë 01 prill 2012, vërtetohet se paditësja M. Q., ka lidhur kontratë me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, nga data 01.04.2012 – në periudhë të pa caktuar, ndërsa nga vërtetimi nr. 24/91 datë 28 janar 2020 provohet se këtu paditësja është në marrëdhënie pune: infermiere në QKMF, me kontratë pune në kohë të pacaktuar nga data 21 maj 1990. Po ashtu nga vërtetimi nr. 383/11 datë 27 shtator 2021 vërtetohet fakti se paditësja e lartpërmendur në cilësinë e infermieres në QKMF, ka 31 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në lartësi 425,55€, si dhe nga qarkullimi për llogarinë NLB Bank datë 29 janar 2020 vërtetohet se realizon pagë prej 422.37€.

Nga Kontrata e punës nr. 146 datë 1 prill 2012, vërtetohet se paditësja M. S., ka lidhur kontratë me: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, nga data 01.04.2012 – në periudhë të pa caktuar, ndërsa nga vërtetimi nr. 24/97, datë 29 janar 2020 provohet se paditësja është në marrëdhënie pune: spec.mjek.familjar në QKMF, me kontratë pune në kohë të pacaktuar nga data 01 shtator 1999. Po ashtu nga vërtetimi nr.383/12 provohet rrethana se paditësja në cilësinë e spec.mjek.familjar në QKMF, ka 26 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në lartësi 698.76€ si dhe nga qarkullimi për llogarinë NLB Bank, datë 29 janar 2020 është vërtetuar fakti se realizon pagë mujore në lartësi prej 727.68 euro.

Nga Kontrata e punës datë 01 prill 2012 vërtetohet se paditësja Q. D. ka lidhur kontratë me Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – 4, nga data 01 prill 2012 – në periudhë të pa caktuar, ndërsa nga vërtetimi nr. 24/46 datë 28 janar 2020 provohet se paditësja është në marrëdhënie pune: infermiere në QKMF - 4, me kontratë pune në kohë të pacaktuar nga data 01 korrik 1988. Po ashtu nga vërtetimi nr. 383/13, datë 27 shtator 2021 është vërtetuar rrethana se paditësja në cilësinë e infermieres në QMF - 4, ka 32 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në lartësi 427.14€, si dhe nga monitorimi i transaksioneve të llogarisë TEB Bank, datë 28 janar 2020, vërtetohet se realizon pagë mujore prej 447.06 €.

Nga Kontrata e punës nr. 294, datë 1 prill 2012, vërtetohet se paditësi N. H., ka lidhur kontratë me : Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – 6 - Ponoshec, nga data 01 prill 2012 – në periudhë të pa caktuar, ndërsa nga vërtetimi nr. 24/126 datë 29 janar 2020 provohet se paditësi është në marrëdhënie pune: infermier në QMF - 6, me kontratë pune në kohë të pacaktuar nga data 13 mars 1985. Po ashtu nga vërtetimi nr. 383/14, datë 27 shtator 2021 provohet fakti se paditësi në cilësinë e infermierit në QMF - 6, ka 37 vjet përvojë pune dhe realizon pagë mujore neto në lartësi 435.07€ si dhe nga monitorimi i transaksioneve të llogarisë TEB Bank, datë 29 janar 2020 vërtetohet se paditësi realizon pagë mujore prej 431.90€.

Sa i përket kërkesës së paditësve të lartpërmendur e cila i referohet shpërblimit jubilar, kjo gjykatë konsideron se e njëjta kërkesë është e bazuar, për faktin se gjen mbështetje në Kontratën Kolektive Sektoriale, të lidhur me datë 12 qershor 2018 në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, përkatësisht në nenin 17 par. 3 të cilës, është paraparë se: “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë; 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në rastin konkret vlen të potencohet edhe fakti se pala pasive në procedurë, nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë së precizuar, ndërsa baza juridike e kërkesëpadisë, u vërtetua nga provat materiale të zbatuara dhe e njëjta gjen edhe mbështetje ligjore sipas dispozitave të sipërcituara. Paditësja M. A. ka mbi 30 vite pune dhe ka realizuar të ardhurat personale neto në shumë prej 435.07€, për këtë i takon shpërblimi jubilar në lartësi të tri pagave në shumë prej 1305.21€, paditësja M. Qarkagjija ka mbi 30 vite pune dhe ka realizuar të ardhurat personale neto në shumë prej 425.55€, për këtë i takon shpërblimi jubilar në lartësi të tri pagave në shumë prej 1276.65€, paditësja M. S. ka mbi 20 vite pune dhe ka realizuar të ardhurat personale neto në shumë prej 698.76€, për këtë i takon shpërblimi jubilar në lartësi të dy pagave në shumë prej 1397.52€, paditësja Q. D. ka mbi 30 vite pune dhe ka realizuar të ardhurat personale neto në shumë prej 427.14€, për këtë i takon shpërblimi jubilar në lartësi të tri pagave në shumë prej 1284.42€, paditësi N.e H. ka mbi 30 vite pune

dhe ka realizuar të ardhurat personale neto në shumë prej 435.07€, për këtë i takon shpërblimi jubilar në lartësi të tri pagave në shumë prej 1305.21€,

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19 qershor 2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditores, përkatësisht këtu paditësve, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet e palës së paditur të theksuara në përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit përgatitor nuk qëndrojnë, të njëjtat nuk patën ndikim për të vendosur ndryshe në rastin konkret dhe si të këtilla u konsideruan irelevante në këtë çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr në kuptim të nenit 450 paragrafi 2 dhe 452.1 të LPK-së, ashtu që paditësve në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shuma e përgjithshme në vlerë prej 738.60€, e cila shumë i referohet pagesës së taksës gjyqësore për padi, shuma prej 21.00€, përpilimi i padisë shuma prej 312.00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve shuma prej 405.60€.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr. 337/2020, datë 12 tetor 2021**

**Gj y q t a r j a,**  
**Afijete Sada – Glllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.